



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skopština Opština Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 16.11.2018, me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Afrim Dina.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, Nënkyetarin Fatmir Iska, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, LMT-së, gazetarët, drejtoret e drejtive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kuorum për mbajtjen e mbledhje ka, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

R E N D D I T E

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Draft - Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2019,
3. Shqyrtimi i Kërkesës së Shoqatave të dala nga lufta të UÇK-së, për emërtimin e disa institucioneve komunale me emrat e dëshmorëve të kombit,
4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për dhënien e pronës së paluajtshme komunale P – 71510008-00331-0, në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite,
5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për dhënien e pronave të paluajtshme komunale në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite,
6. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të veçantë publik dhe kthimit të një pjese të pronës nga “NBI – Rahoveci”, në emër të komunës së Rahovecit,
7. Shqyrtimi i raportit mbi gjendjen e stacionit të autobusëve në komunën e Rahovecit,
8. Të ndryshme.

Kryesuesi – E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar

A ka dikush të shtojë diçka rrëth procesverbalit? Nëse jo e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në votim pikën e parë të rendit të ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari kryesues mua materiali fizik për këtë mbledhje nuk më ka ardhur fare, prandaj tani për këtë mbledhje e kam vetëm materialin të cilin na e shpërndau zyrtari nga zyra e kuvendit.

Kryesuesi – E nderuar do shikojmë se ku ka qenë problemi që nuk ju ka ardhur materiali, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Draft - Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2019.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në bazë të ligjit Nr.06 L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, sipas këtij ligji për çdo vite rregullorja e tatimit në pronë duhet të kalojë përmes kuvendit, për të vërtetuar se a ka nevojë që të bëhet rregullimi i koeficienteve sepse shkallët tatimore janë të njëjtë. Edhe në këtë vite ne si Drejtori e Financave në Rregulloren për tatim në pronën e paluajtshme nuk kemi paraparë që të bëjmë ndryshime sepse kjo rregullore është e njëjtë nga viti i kaluar, ne të gjithë e dimë se nivelet e vlerave dhe e koeficientet në komunën tonë janë më të ulëta në Kosovë. Karakteristik e kësaj rregullore është se për herë të parë fillon së aplikuari edhe tatimi në parcela – tokë, ju njoftoj se tatimi në parcela përfshinë: Parcela në shtëpi familjare të cilat janë të ndara në zona prej 1-6, pastaj i kemi njësitë komerciale të parcelave ku janë të ndara në 6 zona, ku përfshihen: Parcelat në objekte komerciale, parcelat për rekreacion komercial dhe parcelë për transport komercial. Gjithashtu kemi edhe njësitë industriale të parcelave, ku përfshihen katër zonat: parcelë për industri, parcelë për impiant elektrik dhe gropë zhavorri. Pastaj i kemi njësitë e parcelave bujqësore të cilat janë të ndarë në pesë zona: Arë, kullosë, lивадhe, pemishte dhe vreshta. Dhe në fund janë njësitë pyjore të parcelave ku përfshihen në 4 zona, në parcelë pyjore dhe parcela pyjore malore. Përshkrimi i zonave që është bërë në rregullore ka të bëjë kryesish me tatimin në pronë ku ka ngelë e pandryshueshmë, kurse përcaktimi i zonave, shkallëve tatimore dhe koeficienteve të zonave të parcelave është përcaktuar nga departamenti i tatimit në pronë i MF.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari drejtor kjo rregullore miratohet për çdo vit, pastaj pyetje të cilën unë e kisha bërë është: Rregullorja që është në fuqi dhe kjo rregullore që sot jeni duke na prezantuar a kanë ndonjë dallim. Kjo rregullore është shumë me rendësi sepse që nga janari i viti 2019 do të filloj të paguhet tatimi në parcela, po ashtu mendoj se kjo rregullore duhet të dele në diskutim publik, në mënyrë që të njoftohen qytetarët se do të filloj të paguhet edhe tatimi në parcela. Kurse sa i përket ndryshimit se sa do të jetë tarifa e pagesës nuk jam duke e kupuar këto përqindje që i keni paraqitur, por besoj se drejtori do na shpjegoj në mënyrë që ne të kemi pak më të qartë.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kur diskutohet rrëth Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ne që jemi kuvendar për herë të parë i kemi disa paqartësi, edhe pse disa gjëra këtu janë qartësuar, por ajo që së pari desha të sqarohem është: Në email adresë na keni dërguar edhe një pjesë shtesë për këtë pikë të rendit të ditës, por ne nuk e kemi tanë këtu fizikisht edhe pse e kërkova qysh në fillim të mbledhjes. Po ashtu edhe unë i kam disa pyetje: Cili është dallimi në mes kësaj rregullore dhe rregullores së vjetër, pastaj po ashtu edhe unë mendoj nëse rregullorja ka ndryshime duhet që të dele në debat publik, posaçërisht pasi që në rreguloren e re është paraparë që në vitin 2019 të tatimohen edhe tokat, në këtë mënyrë opinioni do të informohet dhe pastaj do të kenë mundësi që të i japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, dhe në këtë mënyrë nuk do të jemi vetëm ne të implikuar në diskutime dhe në vendimet përfundimtare. Po ashtu edhe unë nuk jam duke i kupuar këto të dhëna që i keni paraqitur në formë tabele dhe me përqindje, kishte me qenë mirë drejtori të na shpjegojë këto në mënyrë që të informohemi më mirë.

Fahrije Lushi Morina – Ajo që më intereson të di është: Brenda kësaj draft rregullore në cilën pjesë mendoni se hynë lojërat e fatit të cilat janë të shumta në komunën tonë, dhe cili do të ishte çmimi që kjo kategori do të paguaju. Mendoj që së pari duhet të pyesim se a janë të lejuara këto të ekzistojnë, por së pari kish pas dëshirë të di se cili është çmimi që ata paguajnë për të vepruar, këto asgjë nuk ndihmojnë por ato i degradojnë dhe shkatërrojnë ekonomitë familjare.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, jemi pro asaj që e thanë edhe kolegët e mijë, po ashtu edhe unë e kam pyetjen se çfarë ndryshimi ka kjo rregullore nga e vjetra. Ne kemi pasur edhe gjatë mbledhjeve të tjera biseda se si do të tatimohen tokat, ka pasur zëra se do të tatimohen vetëm tokat që nuk punohen, pastaj dikush ka thënë se do të tatimohen të gjitha tokat, prandaj kërkoi nga drejtori të na jepe një përgjigje pak më të saktë, a do të tatimohen të gjitha tokat apo vetëm ato që nuk punohen.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar kryesues plotë gjëra u thanë nga kolegët, po ashtu edhe unë mendoj se ka rëndësi shumë të madhe që kjo draft rregullore të dele në njoftim publik, sepse qytetarët do ti kenë dy mundësi, e parë që përmes këtij njoftimi ata do të kenë mundësi që të njoftohen mbi taksat e reja që do të janë në vitin 2019, pastaj e dyta ata dojenë të njoftuar mbi vlerën e tatimit

që do i kenë për vitin 2019. Shumë qytetarë nuk janë të informuar mbi këto vlera, dhe pastaj ndodhë që ne të marrim vendim që ti falim borxhet që i kanë ndaj komunës. Nëse dele në njoftim publik ne pastaj do i kemi edhe mendimet e tyre mbi këtë kosto, prandaj mendoj se duhet patjetër të dele në diskutim publik. E tha edhe kolegu para meje se ka pasur diskutime sa i përket tatimit në toka, se do të tatimohen vetëm tokat që nuk punohen, ne duhet të kmeri një përgjigje të saktë në mënyrë që ne të ja transmetojmë qytetarit, mendoj se kjo do të jetë një nxitje që tokat të mos mbeten të papunuara.

Afrim Limani – Të nderuar kuvendar puna e kësaj rregullore edhe për mua është pakës problem të kuptohet e leje më për juve, por unë do mundohem të zgjerohem pak në diskutim në mënyrë që edhe ju ta kuptoni pak më mirë. Kishte shumë pyetje se cili është dallimi në mes kësaj rregullore dhe të vjetrës, të nderuar dallimi në mes këtyre dy rregulloreve është: Rregullorja e Tatimit në Pronë, kur është fjala tek objektet ajo vazhdimisht mbetet e njëjtë dhe nuk ndryshon sepse shkalla tatimore dhe koeficientet janë ndër ma të ulëtat në Kosovë, por kësaj rregullore ju ka bashkangjitur edhe pjesa e parcelave tokësore. Është përgatitur një serverë i përbashkët nga departamenti i tatimit në pronë në MF, së bashku me agjensionin kadastral, të gjitha këto shënime i kanë mbledhur dhe i kanë futur në kuadër të kësaj rregullore. Pastaj po ashtu gati të gjithë ishit që të futet në diskutim publik kjo rregullore, të nderuar MF ka vite që ka punuar në këtë drejtim, ata kanë mbajtur takime me qytetar, mbledhje me ekspertë të ndryshëm, ku pastaj të gjitha ato të dhëna i kanë përpunuuar dhe i kanë futur në këtë rregullore, prandaj konsideroj se pjesa e diskutimi publik është kryer. Z. Fehmi Cena dhe z. Rasim Fazliu pyetet rrëth koeficientet, do mundohem që të ju shpjegoj, i kemi njësitë rezidenciale të parcelave, tani kush hynë në këtë pjesë: Parcelat për shtëpi familjare, për ndërtesë apartamentesh, për objekt tjetër rezidencial, të nderuar pjesa e tokës ku ne e kemi një shtëpi ka me u tatimu, pra shtëpia pluse edhe toka ku ne e kemi shtëpinë e ndërtuar, çmimi është $55 \text{ € për } m^2$, kjo kështu llogaritet $1m^2 \times 55 \text{ €}$ na dele rezultati dhe pastaj vlerën e dhënë e pjesëtojmë me 0.16%, përafërsisht na dele një çmim i lirë. Pastaj i kemi njësitë komerciale të parcelave, njësitë komerciale janë: Nëse një biznes e ka një objekt të vetin atëherë atij i tatimohet pjesa e tokës që e ka jashtë objektit. Kurse sa i përket pjesës së tatimit të tokave, ne kemi toka që janë: Arra, kulloso, livadhe dhe pemishte, çmimi për m^2 është 5.50 € pastaj kjo shumëzohet me koeficient i cili është 0.16 dhe na dele vlera reale, por të nderuar çmimet ndryshojnë sipas zonës, zona e parë e ka çmimin 6.50 €, kurse e zona e dytë e ka çmimin 1.50 €. Të nderuar ashtu siç e kam llogaritur unë më ka dalë për një hektar në zonën e parë diku 104.00 € për një vit, por ajo që është ma karakteristik se me ligjin e financave të departamentit në pronë e ka bërë lejimin, që nga viti e parë e deri në të katërtin totali i vlerës do të tatimohet vetëm me 20%. Kurse sa i përket asaj se do të tatimohen vetëm tokat që nuk janë duke u punuar, ajo nuk është e vërtet të gjitha tokat do të tatimohen. E nderuara znj. Fahrije Lushi sa i përket lojërave të fatit kjo rregullore nuk ka të bëjë me këtë, ajo përfshihet në rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Fehmi Cena – Kishte me qenë më mirë nëse do të sqaroheshin gjërat pak më mirë, ne jemi anëtar të KPF-së dhe e gjitha varet nga ne a do të kalojë kjo pikë për mbledhje të kuvendit. Në tabelën e parë ceket m^2 për shtëpi familjare zona e parë 220.00 €, kjo shumë është për komplet shtëpinë, për një metër, apo për 100 m, a ka dallim shtëpia prej një kati me shtëpitë nga dy ose tre kate, kërkoj nga drejtori që këto të na i sqaroj. Pastaj tani do të dele edhe një obligim për qytetarët tanë ndaj shtetit, gjithçka është në rregull ne jemi që të kontribuojmë për shtetin, por pyetje ime është: A e kanë qytetarët tanë gjendjen ekonomike që në vitin 2019 të fillojnë të paguajnë këtë tatim, edhe pse ne ende nuk e dimë tarifën e saktë se sa do të jetë. E gjithë ka edhe efektet pozitive por edhe negative, tatimi në tokë është pozitiv sepse do i nxisë qytetarët që ta punojmë tokën sa ma shumë, edhe pse komuna jonë dallon nga komunat e tjera sepse shumë pak mundet të gjendët toka e pa punuar tek ne, prandaj unë jam që të punojmë për shtetin por qytetari të jetë në qendër të vëmendjes. Pastaj kjo taks për toka a është në nivel të Kosovës, a ka filluar në ndonjë komunë më herët kjo taksë, shuma e taksës a është për të gjithë Republikën e Kosovës e njëjtë apo dallon, pastaj a është ko taks e domosdoshme që të hyjnë në fuqi vitin 2019 etj. arsyeva pse ne jemi duke kërkuar sqarime është se nëse kjo taks do të jetë e larët dhe e ngarkon qytetarin, kjo atëherë duhet të jetë edhe breng e jona, të gjithë ne e dimë se si është gjendja ekonomike e qytetarëve tanë.

Afrim Limani – I nderuari z. Fehmi Cena shumë me vend e keni ngritur këtë shqetësim, llogaritura për $1m^2$ bëhet sipas formulës dhe të gjitha këto tarifa caktohen nga MF, por qysh në fillim ju ceka se tarifa është më e lirë në Kosovë për m^2 . Departamenti i pronës në MF çmimin real të tregut për komunën tonë e ka qitë 220.00 €, do mundohem që të zbërthej se si duhet të llogaritet sipas formulës, $220 \times m^2$, me ligjin për tatimin në pronë

tek shtëpitë e banimit vlera e dhënë zbritet me 15,000.00 € duke e llogaritur amortizimin dhe në fund na dele rezultati, pastaj ai rezultat shumëzohet me 0.16% dhe na del vlera e dhënë, ja një shembull që e kemi marr për një shtëpi që i ka 100 m² na ka dalë vlera 11.00 €. Kurse sa i përket asaj pyetje se a është bërë kjo në nivel të Republikës apo vetëm për komunën tonë, i nderuar kjo është në nivel të republikës së Kosovës.

Kryesuesi – Ju falënderoj drejtor për sqarimet e dhëna, nëse nuk ka askush të shtoj edhe diçka sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, e qes në votim Draft – Rregulloren për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2019: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dytë (2) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Kërkesës së Shoqatave të dala nga lufta të UÇK-së, për emërtimin e disa institucioneve komunale me emrat e dëshmorëve të kombit.

Bjondina Kleçka – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, duke u bazuar në kontributin e madhe të luftëtarëve dhe dëshmorëve të kombit në çështje kombëtare, shoqatat e dala nga lufta i propozojnë kuvendit komunal disa propozime me emra të dëshmorëve të kombit. Meqenëse emërtimet e rrugëve, shesheve dhe institucioneve komunale ka përfunduar dhe kanë mbetur edhe disa institucione pa emërtime. Besoj se të gjithë e keni para vete kërkesën e OVL-së me emrat e propozuar: Në Rahovec palestra e sportit është propozuar Mizahir Isma, stadiumi i futbollit Jahja Danuza, qendra e kulturës në Krushe të Madhe Muhamed Malsori, qendra e kulturës në Ratkoc Jahë Hoti, qendra e kulturës Drenoc Fehim Gashi dhe qendra e kulturës në Xërxe Shkelzen Krasniqi. Besoj se është e arsyeshme që të përkrahet kjo kërkesë nga ana e juaj që të kalojë për kuvend, ku pastaj atje do të diskutohet më gjerësisht.

Florije Boshnjaku – Mendoj se ky propozim është me vend, shoqatat e dala nga lufta e kanë dhënë propozimin e tyre dhe ne si anëtar të KPF-së duhet të pajtohem me këtë propozim. Ajo që nuk e kam të qartë është tek propozimi i fundit Shkelzen Krasniqi nga cili vend vije, sepse janë dy Shkelzen Krasniqi njëri nga Hoça e Vogël dhe njëri nga fshati Opterush kurse familja e tij jeton në Xërxe.

Vajdin Berisha - Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, e nderuar fjala është për Shkelzen Krasniqin nga fshati Opterush i cili ka mare pjesë në dy luftëra, kurse familja e tije tanë jeton në fshatin Xërxe.

Fehmi Cena – I nderuari kryesues kjo kërkesë ju është drejtuar komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve komunale, kështu është e cekur në kërkesë, ajo që më intereson mua është se ky komision a e ka pasur në shqyrtim këtë kërkesë. Pastaj sa i përket këtyre emrave a është diskutuar me banorët e këtyre vendbanimeve, pra a është marr mendimi i tyre, apo kjo kërkesë me këto emra për herë të parë është duke u diskutuar tanë nga ne.

Dervish Çadranku – Ky angazhim mua me të vërtet më pëlqen shumë sepse me të vërtet janë anashkaluar disa njerëz të cilët kanë dhënë kontribut të madh për çështjen kombëtare dhe luftës së fundit të UÇK-së. Kam një vërejtje sepse kemi një përvojë mjaftë të hidhur tek përmendoret, tek mbishkrimet, tek rrugicat, rrugët të cilat janë të shënuar me emrat e dëshmorëve dhe janë të dëmtuara, kjo tregon pakënaqësinë e dikujt dhe ai atë pakënaqësi e ka shprehur përmes këtij veprimi i cili është shumë i pahijshëm dhe i dënueshëm. Prandaj kishte me qenë mirë që për secilin nga këta emra të propozuar të kemi nga një biografi dhe ta njoftojmë komunitetin rrëth këtij angazhimi, ku pastaj ne do të kishim mare mendimet e tyre, sepse unë kam edhe foto ku janë të prishura përmendoret e dëshmorëve, pastaj tabelat me emrat e rrugëve i kanë hequr për arsyet e pakënaqësisë.

Fahrije Lushi Morina – Po ashtu edhe unë sikurse parafolësit e mijë mendoj se së pari duhet të bisedohet me komunitetin përkatës të këtyre vendeve në mënyrë që të shihet se a janë edhe ata të këtij pajtimi, sa i përket propozimit për fshatin Ratkoc për Jahë Hotin nuk e besoj se është dikush kundër këtij emri, por është një lokalitet i gjerë dhe duhet të mirët më shumë se një mendim.

Florida Bajraktari – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, edhe ne e përkrahim kërkesën e shoqatave të dala nga lufta, por pyetje ime është mos rastësisht kemi edhe ndonjë propozim tjetër përpos këtyre që na kanë ardhur në mënyrë që mos të kemi ndonjë problem më vonë.

Isak Hoti – Shef i zyrës Ligjore – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, u përmend edhe çështja e komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve, të nderuar ne tanë në këtë rast kemi të bëjmë me një ligj krejt tjetër, ligji me Nr.02/L-57 për institucionet kulturës, ku përcaktohet edhe çështja e procedurës se si duhet vepruar për emërtim institucioneve shtetërore. Ne në këtë rast e kemi vetëm një kërkesë nga shoqatat e dala nga lufta, kurs për kuvend do i blejnë propozimet gati, ku pastaj pas propozimeve dhe pas votimit nga ana e juaj do të dalin vendimet. Të nderuar emërtimi i këtyre institucioneve bëhet me vendim të

kuvendit, pra këtë kompetencë e ka ekskluzivisht kuvendi. Nuk është procedurë e njëjtë sikurse emërtimi i rrugëve i cili është bërë me komision.

Rasim Fazliu – E kuptoj plotësisht zyrtarin ligjor kur e tha se kjo është kompetencë e kuvendit, por pyetje është se sa janë të njoftuar qytetarët e komunës sonë rreth këtyre propozimeve, pastaj a ka edhe propozime tjera sepse për mua si Rasim është shumë në rregull dhe janë propozimet me vend, por ne si anëtar të KPF-së dhe kuvendit e kemi hallin që një punë të kryhet me marifet. E njëjtë ka qenë edhe për zgjedhjen e rrugëve sepse edhe këshillat e fshatrave dhe lagjeve kanë dhënë propozime por ne një e kemi përgjedhur dhe në fund prapë kuvendi e ka dhënë mendimin e fundit.

Nënkyetari – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar vetëm desha të ndërlidhem me këtë temë, në kohën kur janë bërë emërtimet e rrugëve, rrugicave dhe shesheve kam qenë edhe unë pjesë e komisionit ku e kemi përfunduar atë punë me sukses, kurse pa përfunduar kanë mbetur emërtimet e institacioneve. Do të kthehem vë vitin 2014 kur kemi diskutuar rreth këtyre propozimeve për emërtim të institacioneve, po ashtu edhe në atë kohë ish nënkyetari i komunës z. Xhemajli Haxhimustafa e ka pasur një kërkesë të tillë, do ju lexoj atë që ka thënë ai në mbledhjen e kuvendit të mbajtur me datë 26.12.2014: Na ka ardhur një propozim nga shoqata e veteranëve ku ju kanë drejtuar komisionit, palestra sportive në Rahovec të emërohet me emrin e dëshmorit Mizair Isma, stadiumi i qytetit të futbollit me emrin Jahja Danuza, qendra kulturore në Krushë të Madhe me emrin e dëshmorit Muhamet Malsori, qendra kulturore Ratkoc Jahë Hoti, qendra kulturore Drenoc Feim Gashi dhe qendra kulturore Xërxë Shkelzen Krasniqi. Kjo ishte në vitin 20147 dhe që nga ajo kohë më kjo kërkesë deri tani nuk na ka ardhur, të nderuar nuk jam duke e mohuar faktin që mundet të ketë edhe kërkesa të tjera, por prapë ju si kuvend mundeni të merrni qëndrim se a duhet të ketë diskutim në vendbanime ku janë këto institucion apo jo, por është lidhë me atë se z. Mizahir Isma është dëshmor i kombit dhe është mare me sport prandaj është propozuar palestra e sporteve, stadiumi i futbollit Rahovec Jahja Danuza po ashtu dëshmor i kombit dhe ka qenë edhe futbollistë, qendra e kulturës Krushë e Madhe Muhamet Malsori, besoj se ju e njihni shumë ma shumë se unë është marr me kulturë etj. pra të nderuar të gjitha propozimet e dhëna janë lidhur me profesionin ode hobin që e kanë pasur dëshmorët e kombit. Është e drejtë ekskluzive e kuvendit që me një vendim të posaçëm me i emërtu këto institucion, si shembull mundemi me e mare bibliotekën e qytetit e cila e mban emrin e dëshmorit Sylejman Krasniqi, kjo është bërë me vendim të kuvendit me datë 17 shkurtë 2013, në përvjetorin e 5 të pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Dervish Cadraku – Mua me të vërtet më pëlqejnë këto propozime të shoqatës të dalë nga lufta për arsyen se janë disa kriter që këta i kanë përfillur ashtu siç e tha edhe kryetari, në bazë të profesionit që e kanë pasur aktivitetet që e kanë pasur para lufte si djem të ri, sepse ju e dini se nëpër institucionet tjera nuk i kemi përshtatur bash kështu, ka raste që nuk është identifikuar fare me shkollë, por ja kanë qitur emrin shkollës. Ajo që është më e rendësishme sot është se këto emra që na kanë ardhur neve kanë dalur nga shoqatat e dala nga lufta dhe për këto është përgjegjëse shoqata, sepse komisioni që ka qenë më parë për rrugë, rrugica dhe sheshe ka devijuar dhe ka dështuar, arsyja pse mendoj që ka dështuar është sepse aktivitetet që i kanë bërë nëpër lokalitetet të ndryshme kanë rënë në ndikimin e qytetarëve të papërgjegjshëm, në vend se të vënë emrin e një dëshmori një rruge ja kanë vunë emrin “babagjyshit tim, zakonisht i vihet emri një rruge ose ndonjë institucioni i atyre njerëzve që kanë dhënë një kontribut për komunitetin dhe kombin, e jo për shtëpinë e vetë, p.sh babagjyshi ndoshta ka qenë shumë i pasur dhe ka kontribuar për shtëpinë e vetë e jo për fshatin dhe shoqërinë Kosovare në përgjithësi. Të nderuar ne kemi plotë emërtime të rrugëve me emra të babagjyshave dhe stërgjysheve kurse ai nuk ka dhënë asnjë kontribut shoqëror. Kurse në këtë rast shoqata ja ka qëlluar me këto emërtimet prandaj unë i përgëzoj dhe jam pro këtij propozimi.

Kryesuesi – E qes në votim Kërkesën së Shoqatave të dala nga lufta të UÇK-së, për emërtimin e disa institucioneve komunale me emrat e dëshmorëve të kombit: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës: Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për dhënien e pronës së paluajtshme komunale P – 71510008-00331-0, në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

Afrim Oruçi – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar para jush keni propozim e Kryetarit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme personave fizik dhe juridik deri në 15 vite, këtu bëhet fjalë për pronë në zonën kadastrale Hoçë e Madhe në vendin e quajtur Kalishk – Grab, kullosë e klasit të gjashtë, kjo pronë është e evidentuar sipas certifikatës 00331-0 m enjë sipërsfaqe prej 10 ari e 37m². Qëllimi i dhënies së

kësaj prone është që të ruhet dhe ritet vlera pronës komunale, po ashtu krijimi i kushteve të volitshme për zhvillimin e aktiviteteve të blegtorisë, dhe dhënie e mundësive që qytetarët të vetëpunësohen. Propozimi ynë është që afati për dhëni në shfrytëzim të kësaj prone të jetë për 15 vite, çmimi fillestar i kësaj prone caktohet sipas Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Pasi kjo pronë të merret nga aplikuesit përmes ankandit publik atëherë do të nënshkruhet edhe një kontratë e veçantë ndërmjet përfituesit dhe komunës së Rahovecit në lidhje me të drejtat dhe obligimet. Ftoj anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të këtij propozimi ta votojnë që ky propozim vendim të kalojë për kuvend.

Rasim Fazliu – I nderuari drejtor kjo parcelë a është e përfshirë në zonën e mbrojtur, apo është jashtë kësaj zone.

Florida Bajraktar – Po ashtu edhe unë jam pro këtij propozim vendimi të kryetarit të komunës pasi që qëllimi i dhënieve së kësaj prone është ruajtja dhe rritja e vlerës si dhe dhënia e mundësisë së qytetarëve për vetëpunësim. Propozimi imë është që për mbledhje të kuvendit i nderuari drejtor të gjitha këto të paraqiten përmes projektorit në mënyrë që të dimë konkretisht se ku janë këto prona.

Afrim Oruçi - Të nderuar kjo parcelë është në zonën kadastrale Hoçë e Madhe, por nuk përfshihet në zonën e mbrojtur me ligj për Hoçë të Madhe. Kurse sa i përket kërkesës së znj. Florida bajraktari, i nderuar ne e kemi përgatitur materialin që ta prezantojmë përmes projektorit, por për shkaqe teknike sot nuk kemi mundur ta realizojmë këtë prezantim, besoj se në takimin e radhës të kuvendit do e bëjmë këtë.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimin të Kryetarit për dhënen e pronës së paluajtshme komunale P – 71510008-00331-0, në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për dhënen e pronave të paluajtshme komunale në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

Afrim Oruçi – Po ashtu edhe këtu kemi të bëjmë me pronë komunale, janë dy parcela në kufi njëra me tjetrën dhe kjo ka qenë arsyaja pse ne kemi vendosur që të i quesim në pako. Këto parcela janë pronë bujqësore e klasit të 3-4, të dy këto parcela përfshin rrëth 60 ari 67m², qëllimi është që të ruhet dhe ritet vlera pronës komunale dhe të i jepet mundësia përfitueseve që të vetëpunësohen dhe të i ritet vlera e të hyrave në komunë, propozimi i kryetarit është që për 15 vite të jepet në shfrytëzim kjo pronë. Ftoj anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të këtij propozimi ta votojnë që ky propozim vendim të kalojë për kuvend.

Rasim Fazliu – Padyshim që e përkrahim propozimin e kryetarit, por pyetje ime për drejtorin është: I nderuar deri tani këto prona a kanë qenë në të shtetit, dhe si ka qenë puna e këtyre pronave. Nëse kanë qenë në shfrytëzim dhe ju ka kaluar afati kishte me qenë mirë që të na tregoni, po ashtu kishte me qenë mirë që për mbledhje të kuvendit të ceket edhe destinimi i kësaj prone, pra për çka mundet të shfrytëzohet kjo pronë.

Fehmi Cena - Padyshim që edhe ne i përkrahim të gjitha këto iniciativa të kryetari të komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës publike për qytetarët tanë, sepse me anë të kësaj ritet vlera dhe ritet punësimi. Po edhe unë po e përsërisë atë që e ceku edhe parafolësi rrëth destinimit, për derisa rek pika e katërt destinimi ceket për blegtori, kurse tek pika e pestë destinimi nuk ceket fare, kishte me qenë mirë që nëse ka destiunim çdo herë të ceket në vendim, në mënyrë që ne ta kemi një qartësi më të madhe rrëth asaj se për çka do të shfrytëzohet ajo parcelë.

Afrim Oruçi – Të nderuar kjo pronë nuk ka qenë në shfrytëzim më herët me ndonjë marrëveshje, janë shfrytëzuar nga personat fizik pa ndonjë marrëveshje, kurse tani të njëjtë persona dëshirojnë që të marrin me në shfrytëzim, pra qëllimi ynë është që prona të jepet me marrëveshje në mes komunës dhe qiramarrësit. Sa i përket asaj që duhet të ceket destinimi, pika e katërt është cekur se destinimi është për blegtori, po ashtu edhe në ankand publik kur të qitet ai do të jetë destinimi, kurse destinimi i kësaj pika është bujqësor.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimin e Kryetarit për dhënen e pronave të paluajtshme komunale në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të veçantë publik dhe kthimit të një pjese të pronës nga “NBI, OLTI, Podrima, Zhdrello, Kosova Trans, 18 Nëntori”, në emër të Komunës së Rahovecit.

Afrim Oruçi – Bëhet fjalë me prona në nivel komune jo vetëm me prona e NBI-së, por edhe me prona që kanë qenë në shfrytëzim nga OP- OLTI, Podrimës, Zhdrellos, Kosova Transit, 18 Nëntorit, Korporatave

Bujqësore, Bashkimi dhe organizata themelore koperuese. Pra këtu bëhet fjalë për ma shumë se një ndërmarrje, neve na ka ikur kjo në propozim vendime kemi cekur vetëm NBI-në, kurse për mbledhje të kuvendit kjo do të përmirësohet. Gjeodetët për këtë kanë punuar më shumë se katër javë ku e kanë ku e kanë evidentuar secilën parcelë ndarës, janë më shumë se katër parcela që janë nën menaxhimin e AKP-së dhe çdo ditë privatizohen ku qiten në ankand publik, por ne kemi evidentuar parcelat të cilat janë brenda fshatrave, pra brenda komuniteteve të cilat nesër minden me ju dashtë edhe ju duhet për zhvillimin qoftë ekonomik qoftë ofrimin e shërbimeve të qytetarëve. Ideja ka qenë që këto prona në fillim të shpalen me interes të veçantë siç është në Fortesë, Bërnjak, celinë, Rahovec, Xërxë, Krushe të Madhe; Opterush, Ratkoc, Drenoc dhe Hoçë e Madhe. Qëllimi i krejt kësaj është që nesër nëse na duhet për të ndërtuar një shtëpi të shëndetit ose për një kënd të lojërave, ose një kënd gjelbërues, një zyre të vendit, ka pasur edhe më shumë, por për momentin janë diku mbi 600 parcela n; nivel komune, ne tani jemi duke diskutuar vetëm mbi 55 hektar prona që janë në nivel komune. Ftoj anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të këtij propozimi ta votojnë propozimi vendimin për shpalje të interesit të përgjithshëm publik dhe kthimit të një pjese të parcelës komunës.

Rasim Fazliu – Mendoj se kjo pikë është pikë më e rëndësishme nga të gjitha pikat që i kemi pasur sot, duke u bazuar në atë që komuna e Rahovecit ka mbetur pa prona, nëse dëshirojmë diçka të ndërtojmë nuk kemi prona tona. Do të ishte një fat i madhe nëse këto prona do të mundemi me i marr nga AKP-ja dhe të jenë të menaxhuara nga komuna, vetëm a ka aso burra që këto prona të i kthejnë në prona komunale sepse janë aq shumë të domosdoshme për ne, e përgëzoj këtë iniciativë dhe nëse realizohet kjo iniciativë do të jemi shumë të suksesshëm.

Florije Boshnjaku – Pajtohem me z. Rasim Fazliun kur e ceku se janë shumë me rëndësi që të kthehen këto prona në menaxhim të komunës. Por i nderuar drejtor NBI, OLTI dhe tjerat që i përmendët, e kanë pasur statusin e ndërmarrjeve shoqërore, dhe të gjithë e dimë se ndërmarrjet shoqërore janë privatizuar, kurse ndërmarrjet publike nuk e lejon ligji që të privatizohen, a ke ndonjë informatë a janë të lira të gjitha këto parcela, apo ka nga ata që janë edhe të privatizuar.

Afrim Oruçi – Ky është material i freskuar në javët e fundit siç e thashë kemi punuar për secilën parcelë, këtu bëhet fjalë për parcelat të cilat nuk janë privatizuar, ne si komunë i kemi pasur mbi 1000 parcela por fatkeqësisht na kanë mbetur mbi 600 parcela, dhe këto parcela që i kemi paraqitur para juve nuk janë të privatizuara dhe as që janë në procedurë për privatizim.

Fehmi Cena – E përkrahim plotësisht këtë propozim vendim sepse është diçka pozitive për komunën tonë, por dilema tek unë është a do të jetë e mundur ligjërisht kjo të realizohet, a ka ndonjë shembull nga ndonjë komunë tjetër që ju është marr AKP-së nga menaxhimini pronat dhe ju janë kthyer komunës në menaxhim.

Afrim Oruçi – Sa për informatë ne të njëjtin material e kemi përcjellë para disa jave edhe Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe AKP-së, nga AKP-ja kemi kërkuar që të pezullojë vendimin për privatizim të këtyre parcelave, kurse Qeverisë së Republikës së Kosovës që të na i rikthej këto parcela sepse kanë qenë tona. Kurse sa i përket mundësisë a është e mundshme kjo të bëhet, janë disa komuna ku Qeveria e Republikës së Kosovës e ka mare një vendim dhe komuna e fusnit e cila ka përfituar nga ky vendim kthimin e dhjetëra pronave është Vushtria, Ferizai, uroj që të kemi të njëjtin fat edhe ne që këto prona të na kthehen nën menaxhimin e komunës.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e Kryetarit për shpalljen e interesit të veçantë publik dhe kthimit të një pjese të pronës nga “NBI – Rahoveci”, në emër të Komunës së Rahovecit: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e gjashtë (6) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i raportit mbi gjendjen e stacionit të autobusëve në komunën e Rahovecit.

Rasim Fazliu – Meqenëse duhet të shkojmë në takim me përfaqësuesit e Syri Vizioni, propozoji që kjo pikë të kalojë për kuvend pastaj aty do ta shqyrtojmë, shpresoj se do të mbështesin edhe kolegët e mi këtë propozim.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e z. Rasim Fazliut: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar propozimi i z. Rasim Fazliut që pika e shtatë të kalojë për shqyrtim në mbledhje të kuvendit.

E qes në votim raportin mbi gjendjen e stacionit të autobusëve në komunën e Rahovecit: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e shtatë (7) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

8. Të Ndryshme.

Florida Bajraktari – I nderuari kryesues më duket se të ka ardhur një kërkesë nga banorët e ndërtesave që gjenden afér komunës, që të jetë si pikë e rendit të ditës në KPF dhe pastaj në Kuvend. Kisha me pas dëshirë ta di arsyen pse nuk është përfshirë sot kjo pikë.


Kryesuesi – E nderuar është e vërtet ne e kemi pranuar një kërkesë nga banorët e këtyre ndërtesave, unë ju kam deleguar kërkesën ekzekutivit, ata janë duke e shqyrtuar kërkesën pas shqyrtimit do dalim me një përgjigje. Nëse nuk ka askush të shtoj edhe diçka sa i përket pikës së fundit, mua më mbetet të ju falënderoj për kontributin e dhënë sot, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 11:20

Procesimbajtësi,

 Skender Hamza



K R Y E S U E S I

 Afrim Dina